



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH  
SIGURIMIT TË SHTETIT**

**INSTITUTI I STUDIMEVE PËR  
KRIMET DHE PASOJAT E  
KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Nr. 237/1 Prot. Datë 12/07/2017

Nr. 558 Prot. Datë 12/07/2017

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH),**  
përfaqësuar nga **Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;**

dhe

**Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (më poshtë**  
**ISKPK),** përfaqësuar nga **Drejtori Z. Agron Tufa:**

Nisur prej interesit të përbashkët të dy Institucioneve palët bien dakord të lidhin këtë  
**Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë “**Marrëveshja**”).

#### **Neni 1** **Objekti**

Objekti i kësaj **Marrëveshje** është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit e dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-sigurimit të shtetit

dhe të organeve të diktaturës komuniste, si dhe bashkëpunimi në fushën e botimeve, kulturës dhe promovimit të saj, që dëshmojnë periudhën për krimet e komunizmit në Shqipëri dhe periudhën që ka funksionuar ish-sigurimi i shtetit.

## **Neni 2** Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është Ligji nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” dhe Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

## **Neni 3** Sfera e bashkëpunimit

**AIDSSH** dhe **ISKPK** angazhohen të bashkëpunojnë në kryerjen e studimeve shkencore dhe edukimin qytetar si dhe në aktivitetet e organizuara prej secilës palë, sipas programeve të miratuara në bashkëpunim bilateral ndërmjet dy Institucioneve.

## **Neni 4** Të drejta dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj **Marrëveshje**, **AIDSSH** dhe **ISKPK** kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. të shkëmbejnë planet vjetore dhe kalendarët e aktiviteteve që dy Institucionet miratojnë;
2. të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj Marrëveshje;
3. të bëjnë të disponueshëm kundrejt kërkesave dhe formularëve të aplikimit, dokumente dhe materiale arkivore që i përkasin periudhës së komunizmit dhe që i nevojiten secilës palë në funksion të veprimtarisë së punës përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat dhe në respektim të kërkesave të parashikuara në nenin 36 dhe 37 të ligjit nr.45/2015;
4. të bashkërendojnë punën për kërkimin shkencor me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit;
5. të bashkërendojnë punën për edukimin qytetar nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshirë dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të asaj periudhe;
6. të organizojnë, hapin ose shkëmbejnë ekspozita që kanë si bazë pasurinë dokumentare apo kulturore në fushat respektive që dy Institucionet mbulojnë sipas ligjit;
7. të organizojnë konferenca, takime, workshop-e për të nxitur ndërgjegjësimin e të gjithë atyre që u janë përpunuar/ruajtur të dhënat nga ish-sigurimi i shtetit, gjatë periudhës së

